

LIGJ
Nr.10 127, datë 11.5.2009

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.2, DATË 8.4.2009 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË
MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR KONTRIBUTIN E BURIMEVE PËR
MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE
DHE NË REPUBLIKËN E ÇADIT (MINURCAT)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 101 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.2, datë 8.4.2009, i Këshillit të Ministrave “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara, për kontributin e burimeve për misionin e Kombeve të Bashkuara në Republikën e Afrikës Qendrore dhe në Republikën e Çadit (MINURCAT)”.

**Shpallur me dekretin nr.6178, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET
KOMBEVE TË BASHKUARA DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR TË KONTRIBUAR
NË BURIMET E MISIONIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA NE REPUBLIKËN AFRIKANE
QENDRORE DHE ÇAD (MINURCAT)**

Duke pasur parasysh se, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Republikën Afrikane Qendrore dhe Çad u krijua në vijim të rezolutës 1861 datë 14 janar 2009 të Këshillit të Sigurimit;

Duke pasur parasysh se, me kërkesë të Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (tani e tutje referuar si Qeveria) kanë rënë dakord për të kontribuar me trupa për Njësinë e Forcës Mbrojtëse për të ndihmuar MINURCAT në realizimin e mandatit të tij;

Duke pasur parasysh se Kombet e Bashkuara dhe Qeveria dëshirojnë të vendosin afate dhe kushte për kontributin,

tashmë, si pasojë, Kombet e Bashkuara dhe Qeveria (tani e tutje bashkërisht të referuara si Palët) kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

1.Për qëllim të këtij memorandumit mirëkuptimi, do të zbatohen përkufizimet e aneksit F.

Neni 2
Dokumentacioni përbërës i Memorandumit të Mirëkuptimit

2.1 Ky dokument, përfshirë të gjitha anekset e tij, përbën tërësisht memorandumin e

mirëkuptimit (tani e tutje referuar si MiM) ndërmjet Palëve për sigurimin e personelit në mbështetje të MINURCAT.

2.2 Anekset

Aneksi A: Personeli

1. Kërkesat

2. Rimbursimi

3. Kushtet e përgjithshme për personelin

Shtojcë. Kutia e ushtarit – Kërkesë e bazuar në misione të veçanta

Aneksi B: Pajisje kryesore - Nuk aplikohet

Aneksi C: Vetëmbështetja – Nuk aplikohet

Aneksi D: Parimet e verifikimit dhe standardet e efektshmërisë për pajisjet kryesore të siguruara në bazë të marrëveshjeve të qirasë me ose pa shërbime shtesë: - Nuk aplikohet

Aneksi E: Parimet e verifikimit dhe standardet e efektshmërisë për pajisjet dytësore dhe mallrat e konsumit të siguruara në bazë të vetëmbështetjes- Nuk aplikohet

Aneksi F: Përcaktimet

Aneksi G: Udhëzime (aide-memoire) për Vendet Trupa-Kontribuese¹

Aneksi H: Standardet e sjelljes së Kombeve të Bashkuara: Jemi Personeli Paqeruajtës i Kombeve të Bashkuara

Neni 3

Qëllimi

3. Qëllimi i memorandumit aktual të mirëkuptimit është përcaktimi i termave dhe kushteve administrative, logjistike dhe financiare për të drejtuar personelin e siguruar nga ana e Qeverisë në mbështetje të MINURCAT dhe për të specifikuar standardet e sjelljes së Kombeve të Bashkuara për personelin e siguruar nga Qeveria.

Neni 4

Zbatimi

4. Memorandumi aktual i Mirëkuptimit aplikohet së bashku me udhëzimet e Vendeve Trupa-Kontribuese.

Neni 5

Kontributi i Qeverisë

5.1 Qeveria ndihmon MINURCAT me personel sipas listës në aneksin A. Çdo personel mbi nivelin e përcaktuar në këtë memorandum mirëkuptimi mbetet përgjegjësi kombëtare dhe si pasojë, nuk i nënshtrohet rimbursimit apo llojeve të tjera të përkrahjes nga Kombet e Bashkuara.

5.2 Qeveria ndihmon MINURCAT me pajisjet kryesore sipas aneksit B. Qeveria siguron që pajisjet kryesore dhe jokryesore të përmbushin standardet e efektshmërisë të përcaktuara në aneksin D gjatë kohëzgjatjes së dislokimit të tyre për MINURCAT. Çdo pajisje mbi nivelin e përcaktuar në këtë memorandum mirëkuptimi mbetet përgjegjësi kombëtare dhe si pasojë, nuk i nënshtrohet rimbursimit apo llojeve të tjera të përkrahjes nga Kombet e Bashkuara.

5.3 Qeveria ndihmon MINURCAT me pajisje dytësore dhe mallra konsumi përsa i përket vetëmbështetjes siç përcaktohen në aneksin C. Qeveria siguron që pajisjet dytësore dhe mallrat e konsumit të përmbushin standardet e efektshmërisë të përcaktuara në aneksin E gjatë kohëzgjatjes së dislokimit të tyre për MINURCAT. Çdo pajisje mbi nivelin e përcaktuar në këtë memorandum mirëkuptimi mbetet përgjegjësi kombëtare dhe si pasojë, nuk i nënshtrohet rimbursimit apo llojeve të tjera të përkrahjes nga Kombet e Bashkuara.

¹ Aneksi G është specifik për misionin dhe nuk është përfshirë në dokumentin aktual. Ai shpërndaheq veçmas para dislokimit.

Neni 6

Rimbursimi dhe mbështetja e Kombeve të Bashkuara

6.1 Kombet e Bashkuara rimbursojnë Qeverinë përsa i përket personelit të vënë në dispozicion sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi në bazë të normave të përcaktuara në nenin 2 të aneksit A.

6.2 Kombet e Bashkuara rimbursojnë Qeverinë për pajisjet kryesore të vëna në dispozicion sipas përcaktimeve të aneksit B. Rimbursimi i pajisjeve kryesore reduktohet në rast se pajisjet në fjalë nuk përmbushin standardet e kërkuara të efektshmërisë të përcaktuara në aneksin D apo në rast se reduktohet lista e pajisjeve.

6.3 Kombet e Bashkuara rimbursojnë Qeverinë për sigurimin e shërbimeve dhe mallrave për vetëmbështetje në bazë të normave dhe niveleve të përcaktuara në aneksin C. Rimbursimi për vetëmbështetjen reduktohet në rast se kontingjenti nuk përmbush standardet e kërkuara të efektshmërisë të përcaktuara në aneksin F apo në rast të reduktimit të vetëmbështetjes.

6.4 Rimbursimi për shpenzimet e trupave/policisë do të vazhdojë në bazë të normave të plota deri në largimin e personelit.

6.5 Rimbursimi për pajisjet kryesore do të jetë në fuqi me normë të plotë deri në datën e ndërprerjes së operacioneve nga ana e kontribuesit të trupave/policisë ose mbarimit të misionit dhe pas kësaj, të përllogaritet me 50% të normës së rënë dakord në këtë memorandum mirëkuptimi deri në datën e largimit të pajisjeve.

6.6 Rimbursimi për plotësimin e nevojave të veta do të jetë në fuqi me normë të plotë deri në datën e ndërprerjes së operacioneve nga ana e kontribuesit të trupave/policisë ose mbarimit të misionit dhe pas kësaj, të reduktohet në 50% të normës së rënë dakord në këtë memorandum mirëkuptimi të përllogaritur në bazë të forcës aktuale të mbetur të trupave/policisë së dislokuar deri kur i gjithë personeli i trupave/policisë të jenë larguar nga zona e misionit.

6.7 Kur Kombet e Bashkuara diskutojnë një kontratë për kthimin në atdhe të pajisjeve dhe transportuesi e tejkalon periudhën prej 14 ditësh mbas datës së pritshme të mbërritjes, kontribuesi i trupave/policisë do të rimbursohet nga ana e Kombeve të Bashkuara sipas normës së kontratës së qirasë pa shërbime shtesë nga data e pritshme e mbërritjes deri në datën aktuale të mbërritjes.

Neni 7

Kushtet e përgjithshme

7.1 Palët bien dakord që kontributi i Qeverisë, si dhe mbështetja nga ana e Kombeve të Bashkuara të drejtohet nga kushtet e përgjithshme të përcaktuara në anekset përkatëse.

Neni 7 bis

Standardet e sjelljes së Kombeve të Bashkuara

7.2 Qeveria garanton se të gjithë anëtarëve të kontingjentit kombëtar të saj u është kërkuar pajtohen me standardet e sjelljes së Kombeve të Bashkuara të përcaktuara në aneksin H të memorandumit aktual të mirëkuptimit.

7.3 Qeveria garanton se të gjithë anëtarët e kontingjentit të saj kombëtar janë familiarizuar dhe kuptojnë plotësisht standardet e sjelljes së Kombeve të Bashkuara. Për këtë qëllim, Qeveria, ndër të tjera, garanton që të gjithë anëtarët e kontingjentit të saj kombëtar të marrin kualifikimin e duhur dhe të efektshëm paradislokues mbi standardet në fjalë.

7.4 Kombet e Bashkuara vazhdojnë të sigurojnë për kontingjentet kombëtare në misione të veçanta materiale kualifikuese mbi standardet e sjelljes, rregullat dhe rregulloret për misione të veçanta, dhe ligjet dhe rregulloret përkatëse të Kombeve të Bashkuara. Për më tepër, Kombet e

Bashkuara ndërmarrin kualifikime induksioni të duhura dhe të efektshme dhe kualifikime gjatë funksionimit të misionit për të plotësuar kualifikimin paradislukes.

Neni 7 ter **Disiplina**

7.5 Qeveria pranon se komandanti i kontingjentit të saj kombëtar është përgjegjës për disiplinën dhe rregullin e të gjithë anëtarëve gjatë funksionimit për MINURCAT. Qeveria, prandaj, garanton se komandantit të kontingjentit të saj kombëtar i është dhënë autoriteti i nevojshëm për të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme me qëllim ruajtjen e disiplinës dhe rregullit midis të gjithë anëtarëve të kontingjentit kombëtar duke siguruar pajtim me standardet e sjelljes, rregullat dhe rregulloret për misione të veçanta, dhe ligjet dhe rregulloret përkatëse të Kombeve të Bashkuara dhe detyrimet ndaj ligjeve dhe rregulloreve kombëtare dhe vendore në përputhje me marrëveshjen e statusit të forcave.

7.6 Qeveria ndërmerr të garantojë, në varësi të çdo ligji të aplikueshëm kombëtar, se Komandanti i kontingjentit të saj kombëtar informon regullisht Komandantin e Forcës mbi çdo çështje serioze lidhur me disiplinën dhe rregullin e kontingjentit të tij kombëtar përfshirë çdo masë disiplinore të marrë për shkelje të standardeve të sjelljes, rregullat dhe rregulloret për misione të veçanta të Kombeve të Bashkuara dhe për mosrespektim të ligjeve dhe rregulloreve vendore.

7.7 Qeveria garanton që komandanti i kontingjentit të saj kombëtar të marrë kualifikimin e duhur dhe të efektshëm paradislukes për kryerjen e duhur të detyrës lidhur me ruajtjen e disiplinës dhe rregullit të duhur midis anëtarëve të kontingjentit.

7.8 Kombet e Bashkuara asistojnë Qeverinë në përmbushjen e kërkesave të saj në bazë të paragrafit 3 më sipër duke organizuar sesione kualifikuese për komandantët mbas mbërritjes së tyre në misionin e Kombeve të Bashkuara mbi standardet e sjelljes, rregullat dhe rregulloret për misione të veçanta dhe mbi ligjet dhe rregulloret vendore.

7.9 Qeveria përdor pagesat e saj të mbarëvajtjes për të siguruar mirëqenie dhe mundësi çlodhjeje të anëtarëve të kontingjentit të saj në mision.

Neni 7 quarter **Hetimet**

7.10 Është e kuptueshme se Qeveria mban përgjegjësinë primare për hetimin e çdo akti të sjelljes së pahijshme ose sjelljes së pahijshme serioze të kryer nga një anëtar i kontingjentit të saj kombëtar.

7.11 Në rast se Qeveria ka arsye *prima facie* ku tregohet se një anëtar i kontingjentit të saj kombëtar ka kryer një veprim të sjelljes së pahijshme serioze, ajo njofton pa vonesë Kombet e Bashkuara dhe ia përcjell çështjen autoriteteve të saj kombëtare përkatëse për qëllime hetimore.

7.12 Në rastin kur Kombet e Bashkuara zotërojnë arsye *prima facie* që tregojnë se një anëtar i kontingjentit kombëtar të Qeverisë ka kryer një akt të sjelljes së pahijshme apo të sjelljes së pahijshme serioze, Kombet e Bashkuara njoftojnë pa vonesë Qeverinë. Nëse nevojitet që të ruhen të dhënat dhe kur Qeveria nuk realizon seancë për mbledhjen e të dhënave, Kombet e Bashkuara, në rastin e sjelljes së pahijshme serioze, sipas nevojës, kur Kombet e Bashkuara kanë informuar Qeverinë mbi pretendimin, mund të fillojnë një proces për mbledhje të dhënash mbi çështjen deri në momentin kur Qeveria të fillojë hetimet e saj. Është e kuptueshme në këtë pikë se çdo hetim i tillë për mbledhjen e të dhënave do të kryhet nga ana e zyrës hetimore përkatëse të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Zyrën Mbikëqyrëse të Shërbimeve të Brendshme në përputhje me rregulloret e organizatës. Çdo hetim i tillë paraprak për mbledhjen e të dhënave përfshin si pjesëtar të ekipit hetimor një përfaqësues të Qeverisë. Kombet e Bashkuara i sigurojnë Qeverisë pa vonesë një raport të plotë mbi hetimin paraprak të

mbledhjes së të dhënave me kërkesën e kësaj të fundit.

7.13 Në rast se Qeveria nuk njofton Kombet e Bashkuara sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga koha e njoftimit nga ana e Kombeve të Bashkuara, se ajo do të ndërmarrë hetimin e saj mbi sjelljen e pahijshme serioze të pretenduar, Qeveria gjykohet jo e gatshme apo e paaftë për të kryer një hetim të tillë dhe Kombet e Bashkuara, sipas nevojës, mund të ndërmarrin një hetim administrativ mbi sjelljen e pahijshme serioze të pretenduar pa vonesë. Hetimi administrativ i realizuar nga ana e Kombeve të Bashkuara përsa i përket çdo anëtar të kontingjentit kombëtar respekton të drejtat ligjore të një procesi të duhur, të parashikuara për personin në fjalë nga ligji kombëtar dhe ndërkombëtar. Çdo hetim administrativ i tillë përfshin si pjesë të ekipit hetimor një përfaqësues të Qeverisë, në rast se Qeveria siguron një person të tillë. Në rast se Qeveria sidoqoftë vendos të fillojë hetimin e saj, Kombet e Bashkuara i vënë në dispozicion pa vonesë Qeverisë të gjithë dokumentacionin në zotërim lidhur me çështjen. Në rastet kur plotësohet një hetim administrativ i Kombeve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara i sigurojnë Qeverisë të dhënat dhe konkluzionet e mbledhura gjatë procesit hetimor.

7.14 Në rastin e një hetimi administrativ të Kombeve të Bashkuara mbi sjelljen e pahijshme serioze nga ana e çdo anëtar të kontingjentit kombëtar, Qeveria bie dakord të udhëzojë komandantin e kontingjentit të saj që të bashkëveprojë dhe shkëmbejë dokumentacionin dhe të dhënat, në varësi të ligjeve ekzistuese kombëtare, përfshirë ligjet ushtarake. Qeveria gjithashtu ndërmerr, nëpërmjet komandantit të kontingjentit të saj, të udhëzojë anëtarët e kontingjentit të saj që të bashkëpunojnë me një hetim të tillë të Kombeve të Bashkuara, në varësi të ligjeve ekzistuese kombëtare, përfshirë ligjet ushtarake.

7.15 Kur Qeveria vendos të fillojë hetimin e saj dhe të përcaktojë apo dërgojë një ose më shumë zyrtarë për të hetuar mbi çështjen, Qeveria vë në dijeni menjëherë Kombet e Bashkuara mbi vendimin në fjalë përfshirë identitetet e zyrtarit apo zyrtarëve në fjalë (tani e tutje “Zyrtarët e Hetimeve Kombëtare”).

7.16 Kombet e Bashkuara bien dakord të bashkëveprojnë plotësisht dhe të shkëmbejnë dokumentacionin dhe të dhënat me autoritetet përkatëse të Qeverisë, përfshirë çdo Zyrtar të Hetimeve Kombëtare, i cili është duke hetuar një sjellje të pahijshme të mundshme ose sjellje të pahijshme serioze nga ana e çdo anëtar të kontingjentit kombëtar të Qeverisë.

7.17 Me kërkesë të Qeverisë, Kombet e Bashkuara bashkëveprojnë me autoritetet kompetente të saj, përfshirë çdo Zyrtar të Hetimeve Kombëtare që është duke hetuar një sjellje të pahijshme të mundshme ose sjellje të pahijshme serioze nga ana e çdo anëtar të kontingjentit kombëtar të saj duke mbajtur lidhje me personelin tjetër kontribues të Qeverisë në mbështetje të MINURCAT, si dhe me autoritetet përkatëse në zonën e misionit me qëllim ofrimin e ndihmës për realizimin e hetimeve të tilla. Për këtë qëllim, Kombet e Bashkuara ndërmarrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar pëlqimin e autoriteteve mikëpritëse. Autoritetet përkatëse të Qeverisë garantojnë se është siguruar nga autoritetet përkatëse të vendit mikëpritës autorizimi paraprak për të drejtën e përdorimit të një personi të dëmtuar apo dëshmitari i cili nuk është anëtar i kontingjentit kombëtar si dhe për mbledhjen apo sigurimin e të dhënave jo në zotërim apo nën kontrollin e kontingjentit kombëtar.

7.18 Në rastet kur Zyrtarët e Hetimeve Kombëtare janë dërguar në zonat e misionit, ata drejtojnë hetimet. Roli i hetuesve të Kombeve të Bashkuara në çështje të tilla mbetet asistenca ndaj Zyrtarëve të Hetimeve Kombëtare, kur nevojitet, në realizimin e hetimeve të tyre përsa i përket p.sh., identifikimit dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve, regjistrimit të deklaratave të tyre, mbledhjes së të dhënave mjeko-ligjore dhe dokumentuese, dhe sigurimi i asistencës administrative si dhe logjistike.

7.19 Në varësi të ligjeve dhe rregulloreve të saj kombëtare, Qeveria vë në dispozicion të Kombeve të Bashkuara hetimet dhe konkluzionet e realizuara nga ana e autoriteteve të saj përkatëse, përfshirë çdo Zyrtar të Hetimeve Kombëtare, mbi sjelljen e pahijshme të mundshme apo serioze të çdo anëtar të kontingjentit të saj kombëtar.

7.20 Kur Zyrtarët e Hetimeve Kombëtare dërgohen në zonën e misionit, ata gëzojnë të njëjtin status ligjor sikur të ishin anëtarë të kontingjentit të tyre përkatës gjatë kohës kur ata ndodhen në zonën e misionit apo vendin pritës.

7.21 Me kërkesë të Qeverisë, Kombet e Bashkuara sigurojnë mbështetje administrative dhe logjistike ndaj Zyrtarëve të Hetimeve Kombëtare gjatë kohës kur ata ndodhen në zonën e misionit apo

vendin pritës. Sekretari i Përgjithshëm, në përputhje me autoritetin e tij, siguron mbështetje financiare, sipas nevojës, për dislokimin e Zyrtarëve të Hetimeve Kombëtare, në situata ku prezenca e tyre kërkohet nga ana e Kombeve të Bashkuara, zakonisht Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse dhe kur mbështetja financiare kërkohet nga ana e Qeverisë. Kombet e Bashkuara do t'i kërkojnë Qeverisë të dislokojë Zyrtarë të Hetimeve Kombëtare për çështje komplekse dhe me rrezik të lartë dhe në rastet e sjelljes së pahijshme serioze. Ky paragraf nuk cenon të drejtën sovranë të Qeverisë për të hetuar çdo sjellje të pahijshme të anëtarëve të kontingjentit të saj.

Neni 7 quinquens

Ushtrimi i autoritetit nga ana e Qeverisë

7.22 Anëtarët ushtarakë dhe çdo civil, në varësi të ligjit ushtarak kombëtar të kontingjentit të siguruar nga Qeveria, i nënshtrohen autoritetit të veçantë të saj për sa i përket krimeve dhe shkeljeve që mund të kryhen prej tyre gjatë kohës së caktuar në njësinë ushtarake të MINURCAT. Qeveria garanton Kombet e Bashkuara se ajo ushtron autoritet të tillë për sa i përket krimeve dhe shkeljeve në fjalë.

7.23 Qeveria më tej garanton Kombet e Bashkuara se ajo ushtron autoritet disiplinor të tillë, sipas nevojës, për sa i përket të gjitha akteve të tjera të sjelljes së pahijshme të kryer nga çdo anëtar i kontingjentit kombëtar të Qeverisë gjatë kohës së caktuar në njësinë ushtarake të MINURCAT të cilat nuk klasifikohen si krime apo shkelje.

Neni 7 sexiens

Përgjegjësia

7.24 Nëse një hetim i Kombeve të Bashkuara apo një hetim i realizuar nga autoritetet kompetente të Qeverisë konkludon se dyshimet e sjelljes së pahijshme nga çdo anëtar i kontingjentit kombëtar të Qeverisë janë të bazuara, Qeveria garanton që çështja t'u përcillet autoriteteve përkatëse për të ndërmarrë veprimet e duhura. Qeveria bie dakord që autoritetet në fjalë të marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë sikur të bëhej fjalë për të njëjtën shkelje apo kundërvajtje disiplinore tjetër në bazë të ligjeve dhe kodit disiplinor përkatës. Qeveria bie dakord të njoftojë rregullisht Sekretarin e Përgjithshëm mbi progresin e arritur përfshirë rezultatin e çështjes.

7.25 Nëse një hetim i Kombeve të Bashkuara, në përputhje me procedurat e duhura, ose hetimi i Qeverisë konkludon se dyshimet e mosveprimit nga ana e komandantit të kontingjentit

a) Për të bashkëpunuar me hetimin e Kombeve të Bashkuara në përputhje me nenin 7 quarter, paragrafi 3 (b), duke u kuptuar se komandanti nuk do të kishte dështuar të bashkëpunonte thjesht po të vepronte në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tij kombëtare ose po të vepronte për hetimin e Qeverisë; ose

b) Për të ushtruar në mënyrë të efektshme urdhërin dhe kontrollin; ose

c) Për të raportuar menjëherë pranë autoriteteve përkatëse ose për të vepruar në lidhje me pretendimet për sjelljet e pahijshme të raportuara janë të bazuara, Qeveria garanton se çështja do t'u përcillet autoriteteve përkatëse për veprimet e duhura. Plotësimi i këtyre aspekteve përcaktohet në vlerësimin e performancës së komandantit të kontingjentit.

7.26 Qeveria kupton rëndësinë e zgjidhjes së çështjeve lidhur me pretendimet e atësisë ku përfshihet një anëtar i kontingjentit. Qeveria, aq sa e lejojnë ligjet e saj kombëtare, do të mundohet të ndihmojë në pretendime të tilla të paraqitura nga ana e Kombeve të Bashkuara duke i përcjellë ato pranë autoriteteve përkatëse kombëtare. Në rastin kur ligji kombëtar i Qeverisë nuk njeh kapacitetin ligjor të Kombeve të Bashkuara për t'i paraqitur pretendime të tilla, atëherë pretendimet do t'i paraqiten Qeverisë nga ana e autoriteteve përkatëse të vendit pritës në përputhje me procedurat ekzistuese. Kombet e Bashkuara duhet të garantojnë që pretendime të tilla të shoqërohen me të dhëna të nevojshme përfundimtare si mostër e ADN-së së fëmijës kur parashikohet nga ligji kombëtar i Qeverisë.

7.27 Duke pasur në mendje detyrimin e komandantit të kontingjentit për të ruajtur disiplinën dhe rregullin e duhur, Kombet e Bashkuara, nëpërmjet Komandantit të Forcës garantojnë që

kontingjenti të dislokohe në misionin e tij në përputhje me marrëveshjen ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë. Çdo ridislokim jashtë marrëveshjes do të realizohet me pëlqimin e Qeverisë apo komandantit të kontingjentit në përputhje me procedurat kombëtare ekzistuese.

Neni 8

Kushte të veçanta

8.1 Faktori i kushteve të ambientit: 2.60%

8.2 Faktori i intensitetit të operacioneve: 3.80%

8.3 Faktori i veprimit armiqësor/braktisjes së detyruar: 3.30%

8.4 Faktori rritës i transportimit: Distanca ndërmjet portit të hipjes në anije në vendin e origjinës dhe porti i hyrjes në zonën e misionit vlerësohet me (nuk aplikohet) ____ milje (____ kilometra). Faktori përcaktohet (nuk aplikohet) në përqindje të normave të rimbursimit.

8.5 Vendndodhjet e mëposhtme janë portet dhe vendet e hyrjes dhe daljes së origjinës të rëna dakord me qëllim përgatitjen e transportimit të trupave/policisë dhe pajisjeve:

Trupat/policia:

Porti/Aeroporti i hyrjes/daljes: Tirana

(në vendin kontribues të trupave/policisë)

Porti/Aeroporti i hyrjes/daljes: N'Djamena

(në zonën e operacioneve)

Shënim. Trupat/policia mund të kthehen në një vend tjetër të përcaktuar nga kontribuesi i trupave/policisë, megjithatë, kostoja maksimale për Kombet e Bashkuara mbetet ajo e vendit të origjinës së rënë dakord. Kur trupat/policia largohen nga një port dalje të ndryshëm për alternativim, porti në fjalë nënkupton portin e hyrjes së rënë dakord për trupat/policinë në fjalë.

Pajisje: Vendi i origjinës: Nuk aplikohet

Porti i hipjes/zbritjes: Nuk aplikohet

(në vendin kontribues)

Ose

Kalimi i kufirit në hipje/zbritje: Nuk aplikohet

(në vendin kontribues kur nuk ka dalje në det ose lëvizje rrugore/hekurudhore)

Porti i hipjes/zbritjes: Nuk aplikohet

(në zonën e misionit)

Neni 9

Pretendime nga palët e treta

9. Kombet e Bashkuara janë përgjegjëse për të shqyrtuar çdo pretendim nga ana e palëve të treta kur humbja ose dëmtimi i pasurisë së tyre ose vdekja apo plagosja personale janë shkaktuar nga ana e personelit apo pajisjet e siguruar prej Qeverisë gjatë realizimit të shërbimeve ose nga çdo aktivitet apo operacion tjetër në bazë të këtij memorandumi mirëkuptimi. Megjithatë, nëse humbja, dëmtimi, vdekja dhe plagosja u shkaktuan për arsye të neglizhencës totale ose të sjelljes së pahijshme të qëllimshme të personelit të siguruar nga Qeveria, Qeveria mbetet përgjegjëse për pretendime të tilla.

Neni 10

Shpërblimi

10. Qeveria do të rimbursojë Kombet e Bashkuara për humbjen ose dëmtimin e pajisjeve dhe pasurisë në pronësi të Kombeve të Bashkuara të shkaktuara nga ana e personelit apo pajisjeve të Qeverisë nëse humbjet dhe dëmtimet në fjalë (a) ndodhën jashtë realizimit të shërbimeve apo çdo aktiviteti ose operacioni tjetër sipas këtij memorandumi mirëkuptimi, ose (b) lindën apo rezultuan si rrjedhojë e neglizhencës totale apo sjelljes së pahijshme të qëllimshme të personelit të Qeverisë.

Neni 11
Marrëveshje plotësuese

11. Palët mund të arrijnë marrëveshje plotësuese me shkrim mbi memorandumun aktual të mirëkuptimit.

Neni 12
Ndryshimet

12. Secila nga palët mund të ndërmarrë një rishikim të nivelit të kontributit që i nënshtrohet rimbursimit nga ana e Kombeve të Bashkuara ose nivelit të mbështetjes kombëtare për të garantuar pajtueshmëri me kërkesat operationale të misionit dhe Qeverisë. Memorandumi aktual i mirëkuptimit mund të ndryshohet vetëm me anë të një marrëveshjeje me shkrim të Qeverisë dhe Kombeve të Bashkuara.

Neni 13
Zgjidhja e konflikteve

13.1 MINURCAT krijon një mekanizëm brenda misionit për të diskutuar dhe zgjidhur, miqësisht me anë të diskutimit me frymën e bashkëpunimit, mosmarrëveshjet që dalin nga zbatimi i memorandumit aktual. Ky mekanizëm përbëhet nga dy nivele të zgjidhjes së konfliktit:

a) Niveli i parë. Drejtori/Shefi i Mbështetjes së Misionit, duke u konsultuar me Komandantin e Forcës/Komisionerin e Policisë dhe Komandantin e Kontingjentit do të mundohen të arrijnë një zgjidhje të konfliktit me anë të diskutimit;

b) Niveli i dytë: Në rast se negociatat e nivelit të parë nuk e zgjidhin konfliktin, një përfaqësues i misionit të përhershëm të shtetit anëtar dhe zëvendëssekretari i përgjithshëm, Departamenti i Mbështetjes Tokësore ose përfaqësuesi i tij/saj, me kërkesë të secilës palë, përpiqen të arrijnë një zgjidhje të konfliktit me anë të diskutimit.

13.2 Konfliktet të cilat nuk janë zgjidhur siç parashikohet në paragrafin 13.1 më sipër mund t'i paraqiten një pajtuesi apo ndërmjetësi të rënë dakord bashkërisht të emëruar nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në rast dështimi, konflikti mund të paraqitet për arbitrazh me kërkesë së secilës palë. Secila palë cakton një arbitër dhe dy arbitrat e caktuar në këtë mënyrë zgjedhin një të tretë si kryetar. Nëse brenda tridhjetë ditëve nga kërkesa për arbitrat asnjë palë nuk ka caktuar një arbitër ose nëse brenda tridhjetë ditëve nga caktimi i dy arbitrave nuk është caktuar arbitri i tretë, secila palë mund t'i bëjë kërkesë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të caktuar një arbitër. Procedurat e arbitrazhit përcaktohen nga arbitrat dhe secila palë mbulon shpenzimet e veta. Vendimi i arbitrazhit përmban një deklaratë rreth arsyeve mbi të cilat është bazuar, dhe pranohet nga palët si vendim përfundimtar mbi konfliktin. Arbitrat nuk kanë autoritet të caktojnë dëmshpërblime mbi interesat ose dëmshpërblime ndëshkuese.

Neni 14
Hyrja në fuqi

14. Memorandumi aktual i mirëkuptimit hyn në fuqi më 15 mars 2009. Detyrimet financiare të Kombeve të Bashkuara në lidhje me rimbursimin e personelit fillojnë nga data e mbërritjes së personelit dhe pajisjeve në zonën e misionit dhe mbeten në fuqi deri në datën e largimit të personelit nga zona e misionit në bazë të planit të tërheqjes së rënë dakord ose në datën reale të largimit, kur vonesa i përket Kombeve të Bashkuara.

Neni 15
Përfundimi i Marrëveshjes

15. Modalitetet për përfundimin e marrëveshjes do të miratohen nga palët pas konsultimeve ndërmjet tyre.

Në dëshmi të kësaj, Kombet e Bashkuara dhe Qeveria e _____ kanë nënshkruar këtë memorandum mirëkuptimi.

Nënshkruar në Nju Jork, më _____, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Për Kombet e Bashkuara
Susana Malcorra
Zv. Sekretare e Përgjithshme
Për Mbështetjen Tokësore

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë
Adrian Neritani
Përfaqësues i Përhershëm
Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë
pranë Kombeve të Bashkuara

ANEKSI A PERSONELI I SIGURUAR NGA QEVERIA

MINURCAT – Shqipëri

1. Kërkesa

1. Qeveria bie dakord të sigurojë personelin e mëposhtëm:

Për periudhën nga data 15 mars 2009

Njësia/nënnjësia	Numri i personelit	Kapaciteti
Shtabi i misionit		Oficerët e shtabit
Shtabi i kontingjentit		Komanda dhe kontrolli kombëtar
Skuadrilja e këmbësores		Shtabi i kompanisë, kompania e këmbësores së lehtë, kompania e zbulimit
Skuadrilja e xhenios		Niveli i forcës në ndërtim vertikal dhe horizontal
Skuadrilja e helikopterëve		Ekipi i mbështetjes së transportit ajror me ekuipazh ajror dhe stafi i mirëmbajtjes
Toga e transportit		Niveli i forcës dhe kapaciteti i transportimit të trupave
Grupi logjistik		Personeli përbërës, transporti, mirëmbajtja e pajisjeve, mbështetja mjekësore dhe financiare për kontingjentin
Toga e policisë ushtarake		Siguria e plotë dhe mbështetja e hetimit
Skuadra mbështetëse e informacionit ushtarak		Shërbime të lidhura me median, ndërlidhjen dhe përkthimin
Njësia e Mbrojtjes së Forcës	63	
Njësia e formuar e policisë		
Totali		

Shënim. Qeveria mund të sigurojë me shpenzimet e veta personel shtesë si element të komandës kombëtare (EKK) ose element mbështetës kombëtar (EMK). Nuk do të ketë pagesë për kostot e trupave/policisë, rotacion ose vetëmbështetje dhe asnjë përgjegjësi tjetër financiare për Kombet e Bashkuara për personelin e EMK.

2. Rimbursimi

2. Qeveria do të rimbursohet si më poshtë:

a) Kostot e trupave/policisë në normën prej 1,028 \$ në muaj për çdo anëtar kontingjenti;

b) Veshje personale, ndihmë financiare për ingranazhe dhe pajisje në normën prej 68 \$ në muaj për çdo anëtar kontingjenti. Kërkesa për pajimet e rekomanduara të trupave/policisë përfshihet në shtojcë;

c) Armatimet personale dhe municionet e stërvitjes në normën prej 5 \$ në muaj për çdo anëtar kontingjenti;

d) Ndihmë financiare për specialistët në normën prej 303 \$ në muaj, për 25 për qind të forcës së trupave ënjësitë e logjistikës duhet të përfshihen në listë] dhe 10 për qind të forcës së trupave të njësisë së këmbësorisë, njësisë së formuar të policisë, shtabit të forcës, shtabit të sektorit dhe njësive të tjera.

3. Personeli i kontingjentit do të marrë drejtpërdrejt nga misioni paqeruajtës një ndihmë financiare ditore prej 1.28 \$ plus një ndihmë financiare për leje pushimi prej 10.50 \$ në ditë për deri në 7 ditë leje të marra gjatë secilës periudhë gjashtëmujore.

3. Kushtet e përgjithshme për personelin

4. Qeveria do të garantojë që personeli i siguruar të përmbushë standardet e vendosura nga Kombet e Bashkuara për shërbimin pranë MINURCAT, ndër të tjera, në lidhje me gradën, përvojën, gjendjen shëndetësore, specializimin dhe njohurinë e gjuhëve të huaja. Personeli do të stërvitet me pajisjet me të cilat furnizohet kontingjenti dhe do të respektojë çdo politikë dhe procedurë që mund të parashtrohet nga Kombet e Bashkuara në lidhje me certifikatat mjekësore ose certifikata të tjera, vaksinime, udhëtime, dërgesa, leje ose ndonjë të drejtë tjetër.

5. Gjatë periudhës në detyrë pranë MINURCAT, Qeveria do të jetë përgjegjëse për pagesën e çdo page, ndihme financiare dhe përfitimi që mund të jetë i kërkueshëm për personelin në përputhje me masat kombëtare.

6. Kombet e Bashkuara do t'i transmetojnë Qeverisë të gjithë informacionin përkatës në lidhje me sigurimin e personelit, përfshirë çështjet e përgjegjësisë për humbje ose dëm ndaj pronës së Kombeve të Bashkuara dhe kërkesa kompensimi në lidhje me vdekjen, plagosjen ose sëmundjen që atribuohet nga shërbimi i Kombeve të Bashkuara dhe/ose humbja e pronës personale. Ankesat për vdekje dhe incidente që shkaktojnë paaftësi për punë do të trajtohen në përputhje me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 52/177 të datës 18 dhjetor 1997. Udhëzimet për paraqitjen e ankesave që lindin nga vdekja dhe incidentet që shkaktojnë paaftësi për punë jepen me hollësi në dokumentin A/52/369 të datës 17 shtator 1997.

7. Çdo personel mbi forcën e autorizuar në këtë memorandum mirëkuptimi përbën përgjegjësi kombëtare dhe nuk i nënshtrohet rimbursimit ose mbështetjes nga Kombet e Bashkuara. Ky personel mund të dislokohet pranë MINURCAT me miratimin paraprak të Kombeve të Bashkuara nëse gjykohet nga kontribuesi i trupave/policisë dhe Kombet e Bashkuara, që nevojitet për qëllime kombëtare, për shembull të operojë pajisjet e komunikimit për një pikë kontakti kombëtar në prapavijë. Ky personel do të jetë pjesë e kontingjentit dhe si i tillë gëzon statusin ligjor të anëtarëve të MINURCAT. Megjithatë, kontribuesi i trupave/policisë nuk do të marrë asnjë rimbursim në lidhje me këtë personel dhe Kombet e Bashkuara nuk do të pranojnë asnjë detyrim ose përgjegjësi financiare për këtë personel. Çdo mbështetje ose shërbim do të riankimohet nga rimbursimi në lidhje me kontribuesit e trupave/policisë.

8. Personeli i dislokuar, me kërkesë të Kombeve të Bashkuara për detyra specifike të një kohëzgjatjeje të kufizuar, mund të mbulohet nga masa plotësuese për këtë memorandum mirëkuptimi, sipas nevojës.

9. Personeli kombëtar civil i siguruar nga Qeveria që shërben si pjesë e një grupi të formuar trupash/policie do të përfshihet me anëtarët e njësisë të grupeve të formuara të trupave/policisë për

qëllim të këtij memorandumi mirëkuptimi.

10. Masat e përgjithshme administrative dhe financiare të zbatueshme për sigurimin e personelit ushtarak dhe personelit tjetër do të jenë ato të parashtruara në udhëzimet për vendet kontribuese ndaj trupave në aneksin G.

Shtojca 1 e aneksit A

Pajimet e ushtarit- kërkesë e rekomanduar specifike për misionin

Me qëllim plotësimin e kërkesave minimale operacionale më poshtë, paraqitet një listë e zërave të kërkuar. Kërkesat aktuale specifike për misionin do të diskutohen dhe miratohen gjatë bisedimeve të memorandumit të mirëkuptimit

Shembull i kërkesave për kontingjentin e këmbësorisë

Përshkrimi	Sasia
Artikuj të sigurisë dhe sigurisë personale: Helmetë luftimi	1
Veshje mbrojtëse (jelek antiplumb)	1
Artikuj uniforme: Xhaketë luftimi, peshë e lehtë	2
Këmishë me mëngë të gjata	2
Kanotiere	4
Pantallona luftimi, peshë e lehtë	2
Shami xhepi	6
Çizme për luftimin në shkretëtirë	1
Çorape vere	4
Mushama shiu	1
Pantallona të shkurtra	2
Mbathje	4
Llastiqe çorapësh	1
Peshqir dore	2
Artikuj pajisjesh: Dyshek fushor gjumi	1
Valixhe fushore	1
Furçë dhëmbësh	1
Thikë guzhine	1
Lugë	1
Pirun	1
Kusi	1
Kanë	2
Furçë pastrimi	1
Pagure uji	1
Rrjetë individuale mushkonjash	1
Fener ndriçues	1
Pajime mbijetese	1
Kutia e ndihmës së shpejtë	1
Veshje luftimi	1
Dorashka mjekësore njëpërdorimëshe	1
Busull	1
	1
Artikuj shtesë: Siç kërkohet dhe negociohet	1

Pajime policore- kërkesë e rekomanduar specifike për misionin

Me qëllim plotësimin e kërkesave minimale operacionale më poshtë paraqitet një listë e zërave të kërkuar. Kërkesat aktuale specifike për misionin do të diskutohen dhe miratohen gjatë bisedimeve të memorandumit të mirëkuptimit.

Përshkrimi	Sasia
Artikuj të sigurisë dhe sigurisë personale: Helmetë me mbrojtëse fytyre	1
Parzmore e nivelit 4	1
Artikuj uniforme: Xhaketë policore, peshë e lehtë	2
Këmishë me mëngë të gjata	2
Kanotiere	4
Pantallona policore, peshë e lehtë	2
Shami xhepi	6
Çizme shkretëtire	1
Çorape vere	4
Pantallona të shkurtra	2
Mbathje	4
Peshqir dore	2
Bilbil	1
Llastiqe çorapësh	1
Mushama shiu	1
Zëra të pajisjeve personale: Dyshek fushor gjumi	1
Valixhe fushore	1
Furçë dhëmbësh	1
Thikë guzhine	1
Lugë	1
Pirun	1
Tenxhere	1
Kanë	1
Furçë pastrimi	2
Pagure uji	1
Rrjetë individuale mushkonjash	1
Busull	1
Fener ndriçues	1
Pajime mbijetese	1
Kutia e ndihmës së shpejtë	1
Veshje luftimi	1
Dorashka mjekësore njëpërdorimëshe	1
Zëra pajisjesh: Shkop polici	1
Mburojë	1
Maskë gazi	1
Mbrojtës këmbësh/krahësh	1

ANEKSI F PËRKUFIZIME

1. Standardet e pranuar të gatishmërisë së Kombeve të Bashkuara nënkuptojnë që çdo njësi/formacion, anije, sistem armatimi ose pajisje duhet të jetë e aftë të përmbushë misionet ose funksionet për të cilat është organizuar ose planifikuar për të mundur arritjen e mandatit të misionit.

2. Artikujt e konsumueshëm nënkuptojnë furnizimet e një natyre të përgjithshme, të konsumuara rregullisht. Artikujt e konsumueshëm përfshijnë pajisjet e luftimit, rezervat e përgjithshme dhe teknike, rezervat e mbrojtjes, municioni/lëndët plasëse dhe artikujt e përdorimit bazë

në mbështetje të pajisjeve kryesore si dhe në mbështetje të pajisjeve dytësore dhe personelit.

3. Kontingjent nënkupton të gjitha njësitë e formuara, personelin dhe pajisjet e kontribuesit të trupave/policiisë të dislokuar në zonën e misionit sipas këtij memorandum.

4. Pajisjet e zotëruara nga kontingjenti nënkuptojnë pajisjet kryesore dhe pajisjet dytësore dhe artikujt e konsumueshëm, të dislokuar dhe të operuar nga kontingjenti i kontribuesit të trupave/policiisë në përmbushje të operacioneve paqeruajtëse.

5. Faktori i kushteve mjedisore nënkupton një faktor të zbatueshëm për normat e rimbursimit për pajisje kryesore dhe për vetëmbështetje për të marrë në konsideratë kostot e rritura të përballuara nga kontribuesi i trupave/policiisë për kushte ekstreme malore, klimaterike dhe kushte të terrenit. Ky faktor zbatohet vetëm nën kushte të kostove të konsiderueshme shtesë të parashikuara për kontribuesin e trupave/policiisë. Faktori përcaktohet në fillim të misionit nga ekipi vëzhgues teknik dhe zbatohet në nivel ndërkombëtar brenda misionit. Faktori nuk duhet të tejkalojë 5 për qind të normave.

6. Asgjësimi i municioneve të rrezikshme (EOD) nënkupton në kontekstin e EOD, zbulimin, identifikimin, vlerësimin në vend, bërjen të sigurt, përpunimin dhe asgjësimin përfundimtar të municionit të paplasur. Ai kryhet në emër të misionit nga një njësi e specialitetit si kapacitet force. Operacionet e forcës së EOD mund të kryejnë aktivitete në të gjithë ose në pjesë të zonës së misionit. Ai mund të përfshijë gjithashtu municion që është bërë i rrezikshëm nga dëmi ose përkeqësimi.

7. Asgjësimi i municioneve të rrezikshme (EOD) nënkupton, në kontekstin e vetëmbështetjes, EOD të kryer nga një njësi brenda zonës së tij të akomodimit/kampit.

8. Komandanti i Forcës nënkupton oficerin e emëruar nën varësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, përgjegjës për të gjitha operacionet ushtarake brenda misionit.

9. Braktisje e detyruar nënkupton veprimet që rrjedhin nga një vendim i miratuar nga Komandanti i Forcës/Komisioneri i Policiisë ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ose një klauzolë në rregullat e angazhimit që rezultojnë në humbjen e kujdestarisë dhe kontrollit të pajisjeve dhe furnizimeve.

10. Vlera e përgjithshme e pranueshme e tregut (GFMV) nënkupton vlerësimet e pajisjeve për qëllime rimbursimi. Llogaritet si çmim i pranueshëm fillestar i blerjes plus çdo përmirësim kryesor kapital i përshtatur për inflacionin dhe i zbritur për ndonjë përdorim të mëparshëm ose vlerë zëvendësimi, cilado qoftë më e ulët. Vlera e përgjithshme e pranueshme e tregut përfshin të gjithë zërat e shoqëruar me pajisjet në përmbushjen e rolit të tyre operacional.

11. Qeveri nënkupton qeverinë e shtetit pjesëmarrës.

12. Kreu i Misionit nënkupton përfaqësuesin special/komandantin e emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm me miratimin e Këshillit të Sigurisë, përgjegjës për të gjitha aktivitetet e Kombeve të Bashkuara brenda misionit.

13. Veprim armiqësor nënkupton një incident nga veprimi (veprimet) e një ose më shumë ndërlyftuesve që ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshëm negativ mbi personelin dhe/ose pajisjet e një kontribuesi trupash/policie. Aktivitete të ndryshme mund të karakterizohen si një veprim i vetëm armiqësor kur mund të kenë lidhje me njëra-tjetrën për çështje të interesit të përbashkët.

14. Faktori i braktisjes së detyruar/veprimit armiqësor nënkupton një faktor të zbatuar për secilën kategori të normave të vetëmbështetjes dhe ndaj pjesëve të këmbimit (ose gjysmës së normës së llogaritur të mirëmbajtjes) të normës së qirasë, përfshirë dhe shërbimet, për të kompensuar kontribuesin e trupave/policiisë për humbje dhe dëm. Faktori përcaktohet në fillim të misionit nga ekipi vëzhgues teknik dhe zbatohet në nivel ndërkombëtar brenda misionit. Faktori nuk duhet të tejkalojë 5 për qind të normave.

15. Faktori i rritës i transportimit nënkupton një faktor që duhet të mbulojë kostot e rritura të transportimit të pjesëve të këmbimit dhe artikujve të konsumueshëm sipas sistemit të qirasë, përfshirë dhe shërbimet ose qirasë për mirëmbajtjen në rritje prej 0,25 për qind të normës së qirasë për çdo distancë të plotë prej 800 kilometrash (500 milje), mbi 800 kilometrat e parë (500 milje) përgjatë një rruge dërgese midis portit të imbakimit në vendin pritës dhe portit të hyrjes në zonën e misionit. Për vendet e mbyllura ose vendet ku pajisjet zhvendosen me rrugë tokësore ose hekurudhore për dhe në

zonën e misionit, porti i hyrjes në zonën e misionit do të jetë një pikë kalimi kufitar e rënë dakord.

16. Furnizimi fillestar nënkupton një masë mbështetëse logjistike në një mision paqeruajtës përmes të cilës shteti kontribues siguron racione, ujë dhe POL për kontingjentin/njësine mbi baza të rimbursueshme. Rimbursimi do të bëhet për kontribuesit e trupave/policisë pas paraqitjes së faturave. Normalisht, furnizimi fillestar për kontingjentët/njësitë kërkohet vetëm për dislokimin fillestar të kontingjentit/njesisë dhe për një periudhë të kufizuar (30-60 ditë) derisa Kombet e Bashkuara të jenë në gjendje t'i sigurojnë këto artikuj të konsumueshëm. Kërkesa për furnizimin fillestar të ujit, racionet dhe karburantin do të përcaktohet në udhëzimet TCC/PCC.

17. Faktori i kushteve të intensifikuara operacionale nënkupton një faktor të zbatueshëm për normat e rimbursimit për pajisjet kryesore dhe për normat e vetëmbështetjes për të kompensuar kontribuesin e trupave/policisë në lidhje me kostot e rritura që rrjedhin nga fusha veprimi të detyrës së caktuar, zgjatimi i zinxhirëve logjistikë, mosdisponueshmëria e riparimit komercial dhe lehtësirat e mbështetjes, si dhe rreziqet dhe kushtet e tjera operacionale. Faktori përcaktohet në fillim të misionit nga ekipi vëzhgues teknik dhe zbatohet në nivel ndërkombëtar brenda misionit. Faktori nuk duhet të tejkalojë 5 për qind të normave.

18. Marrja me qira e pajisjeve kryesore:

a) Qiraja, pa përfshirë shërbimet, nënkupton një sistem rimbursimi pajisjesh të zotëruara nga kontingjenti ku kontribuesi i trupave/policisë siguron pajisje për misionin dhe Kombet e Bashkuara marrin përsipër përgjegjësinë për mosdisponueshmërinë e burimeve të tyre ushtarake për interesin kombëtar të pajisjeve kryesore të dislokuara dhe pajisjeve dytësore shoqëruese;

b) Qiraja, përfshirë dhe shërbimet, nënkupton një sistem rimbursimi të zotëruar nga kontingjenti ku kontribuesi i trupave/policisë parashikon dhe merr përsipër përgjegjësi për mirëmbajtjen dhe mbështetjen e artikujve kryesorë të dislokuar të pajisjeve së bashku me pajisjet dytësore shoqëruese. Kontribuesi i trupave/policisë ka të drejtën e rimbursimit për sigurimin e kësaj mbështetjeje.

19. Humbje ose dëm nënkupton një eliminim të përgjithshëm ose të pjesshëm të pajisjeve dhe/ose furnizimeve që rrjedhin nga:

a) Një incident pa përfshirë sigurimet;

b) Veprime të një ose më shumë ndërluftuesve;

c) Një vendim të miratuar nga Komandanti i Forcës/Komisioneri i Policisë.

20. Norma e mirëmbajtjes nënkupton normën e rimbursimit për të kompensuar Qeverinë për kostot e mirëmbajtjes që përbëjnë pjesët e këmbimit, riparimin e kontraktuar dhe mirëmbajtjen e linjës së tretë dhe të katërt që kërkohet për të ruajtur operueshmërinë e zërave të pajisjeve në përputhje me standardet e specifikuara dhe kthimin e artikullit në gjendjen operacionale me kthimin nga zona e misionit. Kostot e personelit të përfshira në mirëmbajtjen e linjës së parë dhe të dytë përjashtohen nga norma kur rimbursohen veçmas. Norma përfshin një normë të rritur transportimi për të mbuluar kostot e përgjithshme të transportimit të pjesëve të këmbimit. Kjo normë përbën pjesë të normës së qirasë, përfshirë dhe shërbimet.

21. Pajisje kryesore nënkupton zëra kryesorë që kanë lidhje drejtpërdrejt me misionin e njesisë siç përcaktohet reciprokisht nga Kombet e Bashkuara dhe kontribuesi i trupave/policisë. Pajisjet kryesore argumentohen ose me kategori, ose individualisht. Norma të veçanta rimbursimi zbatohen për secilën kategori zërash të pajisjeve kryesore. Këto norma përfshijnë rimbursimin për pajisje dytësore dhe artikuj të konsumueshëm në mbështetje të zërit të pajisjes kryesore.

22. Pajisje dytësore nënkuptojnë pajisjet në mbështetje të kontingjentëve si katering, akomodimi, komunikimi për jo-specialistët dhe aktivitete xhenioje dhe aktivitete të tjera që kanë lidhje me misionin. Argumentimi specifik i pajisjeve dytësore nuk kërkohet. Pajisjet dytësore ndahen në dy kategori: artikujt e caktuar për pajisjet kryesore mbështetëse dhe artikujt që drejtpërdrejt ose jo mbështesin personelin. Për pajisjet dytësore në lidhje me personelin, zbatohen normat e rimbursimit për vetëmbështetje.

23. Sjellja e pahijshme nënkupton çdo veprim ose mosveprim që është shkelje e standardeve të sjelljes së Kombeve të Bashkuara, rregullave dhe rregulloreve specifike për misionin ose detyrimet ndaj ligjeve dhe rregulloreve kombëtare dhe lokale, në përputhje me marrëveshjen e statusit të forcave, ku ndikimi është jashtë kontingjentit kombëtar.

24. Rregulla dhe rregullore specifike për misionin nënkuptojnë, duke marrë parasysh paralajmërimet kombëtare, procedurat standarde operuese, direktivat dhe rregulloret e tjera, urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Kreu i Misionit, Komandanti i Forcës ose Oficeri Kryeadministrator i misionit paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me standardet e sjelljes të Kombeve të Bashkuara; ato do të përmbajnë informacion mbi ligjet dhe rregulloret e zbatueshme lokale dhe kombëtare.

25. Incident pa përfshirë sigurimet nënkupton një incident që rezulton nga një ngjarje aksidentale ose sjellje e neglizhuar, por nuk përfshin veprime që i atribuohen sjelljes së pahijshme me dashje ose neglizhencës serioze nga ana e operatorit/kujdestarit të pajisjes.

26. Municion operacional nënkupton municionin (përfshirë sistemet vetëmbrojtëse ajrore si municionet brizante ose shkrepjet infra të kuqe) që Kombet e Bashkuara dhe kontribuesit e trupave/policisë bien dakord të dislokojnë në zonën e misionit në mënyrë që të jenë lehtësisht të disponueshme për përdorim në rast nevojë. Municioni i harxhuar për stërvitje/trajnim operacional mbi standardet e pranuar të gatishmërisë të Kombeve të Bashkuara në varësinë dhe drejtimin specifik të Komandantit të Forcës në pritje të një kërkesë operacionale, do të konsiderohet municion operacional.

27. Komisioner Policie nënkupton oficerin e emëruar nën varësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, përgjegjës për të gjitha operacionet policore brenda misionit.

28. Vizita para dislokimit janë vizita nga Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse/Departamenti i ekipeve të misionit në terren/mbështetjes në terren që përbëhen nga përfaqësues nga zona të përshtatshme funksionale (Shërbimi i Gjenerimit të Forcës, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Terren, Drejtoria e Mbështetjes Logjistike etj.) në vende të shteteve anëtare. Ata zotohen të ndihmojnë shtetet anëtare të përgatisin kontingjentët e tyre për dislokim dhe të sigurojnë që kontribuesit e Shtetit Anëtar plotësojnë kërkesat operacionale të misionit dhe afatet kohore të dislokimit.

29. Hetime paraprake zbuluese nënkuptojnë ruajtjen e provave të nevojshme për të siguruar që një hetim kombëtar ose i Kombeve të Bashkuara mund të kryhet në mënyrë të suksesshme gjatë një faze të mëvonshme. Ndërsa ky hetim mund të përfshijë mbledhjen e deklaratave me shkrim, ai normalisht nuk do të përfshijë marrjen në pyetje të dëshmitarëve ose personave të tjerë të përfshirë.

30. Vetëmbështetje nënkupton një koncept mbështetjeje logjistike për njësinë policore/kontingjentin e trupave në një mision paqeruajtës përmes të cilit shteti kontribues siguron mbështetje specifike ose logjistike për kontingjentin mbi baza të rimbursueshme.

31. Sjellje e pahijshme serioze është sjellje e pahijshme, duke përfshirë veprat penale që rezultojnë ose kanë të ngjarë të rezultojnë në humbje serioze, dëm ose plagosje/dëmtim të një individi ose një misioni. Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual përbëjnë sjellje të pahijshme serioze.

32. Abuzim seksual nënkupton ndërhyrjen fizike reale ose të kërcënuar të një natyre seksuale qoftë me forcë ose nën kushte të pabarabarta ose shtrënguese.

33. Shfrytëzim seksual nënkupton çdo abuzim real ose në tentativë të një pozicioni dobësie, pushteti diferencial ose besimi për qëllime seksuale, duke përfshirë, por jo kufizuar në përfitimet monetare, sociale ose politike nga shfrytëzimi seksual i një personi tjetër.

34. Pajisje unike nënkuptojnë çdo pajisje dytësore speciale ose artikull të konsumueshëm që nuk mbulohet në normat e mësipërme të vetëmbështetjes dhe do të trajtohet si pajisje unike.

Këto zëra do të trajtohen në një marrëveshje dypalëshe të një rasti të veçantë midis kontribuesit të trupave dhe Kombeve të Bashkuara.

ANEKSI H NE JEMI PERSONELI I KOMBEVE TË BASHKUARA

Organizata e Kombeve të Bashkuara mishëron aspiratat për paqe të të gjithë popujve të botës.

Në këtë kontekst, Karta e Kombeve të Bashkuara kërkon që i gjithë personeli duhet të ruajë standardet më të larta të integritetit dhe sjelljes.

Ne do të respektojmë udhëzimet mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare për forcat që ndërmarrin operacione paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara dhe pjesët e zbatueshme të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut si baza themelore e standardeve tona.

Ne, si personel paqeruajtës, përfaqësojmë Kombet e Bashkuara dhe jemi të pranishëm në vend për ta ndihmuar atë të rimëkëmbet nga trauma e një konflikti. Për pasojë, ne duhet të përgatitemi në mënyrë të vetëdijshme për të pranuar kufizimet e veçanta në jetën tonë publike dhe private, me qëllim që të kryejmë punën dhe të aspirojmë idealet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Ne do të gëzojmë disa privilegje dhe imunitete të rregulluara përmes marrëveshjeve të negociuara ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe vendit pritës vetëm për qëllim të përmbushjes së detyrave tona paqeruajtëse. Pritshmëritë e komunitetit botëror dhe popullsisë lokale do të jenë të larta dhe veprimet tona, sjellja dhe të folurit do të monitorohen nga afër.

Ne gjithmonë:

- Do të sillemi në mënyrë profesionale dhe të disiplinuar;
- Do të jemi të përkushtuar për të arritur qëllimet e Kombeve të Bashkuara;
- Do të kuptojmë mandatin dhe misionin dhe do të pajtohemi me dispozitat e tyre;
- Do të respektojmë mjedisin e vendit pritës;
- Do të respektojmë ligjet, zakonet dhe praktikat lokale dhe do të informohemi për dhe do të respektojmë kulturën, fenë, traditat dhe çështjet gjinore;
- Do t'i trajtojmë banorët e vendit pritës me respekt, mirësjellje dhe nderim;
- Do të veprojmë me paanësi, ndershmëri dhe takt;
- Do të mbështesim dhe ndihmojmë të pafuqishmit, të sëmurët dhe të dobëtit;
- Do t'u bindemi eprorëve/drejtnesve tanë të Kombeve të Bashkuara dhe do të respektojmë zinxhirin e komandimit;
- Do të respektojmë të gjithë anëtarët e tjerë paqeruajtës të misionit pavarësisht nga statusi, grada, origjina etnike ose kombëtare, raca, gjinia ose besimi;
- Do të mbështesim dhe nxisim sjelljen e duhur mes personelit tonë paqeruajtës;
- Do të raportojmë në lidhje me të gjitha veprimet që përfshijnë shfrytëzim dhe abuzim seksual;
- Do të mbajmë gjithmonë veshje të përshtatshme dhe qëndrim personal ;
- Do të argumentojmë siç duhet të gjitha paratë dhe pronat që na janë dhënë neve, anëtarëve të misionit; dhe
- Do të kujdesemi për të gjitha pajisjet e Kombeve të Bashkuara të cilat na janë ngarkuar.

Ne asnjëherë:

- Nuk do të diskreditojmë Kombet e Bashkuara ose kombet tona me sjellje personale të papërshtatshme, mospërmbushje të detyrave tona ose abuzim me detyrën si personel paqeruajtës;
- Nuk do të marrim masa që mund të rrezikojnë misionin;
- Nuk do të abuzojmë me pije alkoolike, përdorim ose trafikim droge;
- Nuk do të bëjmë komunikime të paautorizuara me agjencitë e jashtme, përfshirë deklaratat e paautorizuara për shtyp;
- Nuk do të zbulojmë ose përdorim në mënyrë të papërshtatshme informacion të fituar përmes punësimit tonë;
- Nuk do të përdorim dhunë të panevojshme ose nuk do të kërcënojmë të burgosurit;
- Nuk do të kryejmë asnjë veprim që mund të çonte në dëm ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike ndaj anëtarëve të popullsisë lokale, veçanërisht grave dhe fëmijëve;
- Nuk do të kryejmë asnjë veprim që përfshin shfrytëzim dhe abuzim seksual, aktivitet seksual me fëmijë nën moshën 18 vjeç ose shkëmbim parash, punësim, mallra ose shërbime për seks;
- Nuk do të përfshihemi në lidhje seksuale që mund të cenonin paanësinë tonë ose mirëqenien e të tjerëve;
- Nuk do të jemi abuzues ose të paqytetëruar me njerëzit;

- Nuk do të dëmtojmë ose shpërdorojmë me dashje ndonjë pronë ose pajisje të Kombeve të Bashkuara;

- Nuk do të përdorim një automjet në mënyrë të gabuar ose pa autorizim;
- Nuk do të koleksionojmë suvenire të paautorizuara;
- Nuk do të marrim pjesë në ndonjë aktivitet të paligjshëm, praktika korruptive ose të papërshtatshme ose nuk do të përpiqemi të përdorim detyrat tona për përfitim personal për të bërë

ankesa të rreme ose për të pranuar përfitime për të cilat nuk kemi të drejtë.

Ne kuptojmë se pasojat e mosveprimit tonë brenda këtyre udhëzimeve:

- Mund të ulin besimin në Kombet e Bashkuara;
- Mund të rrezikojnë arritjen e misionit;
- Mund të rrezikojnë statusin tonë dhe sigurinë si personel paqeruajtës; dhe
- Mund të çojnë në masa administrative, disiplinore ose penale.